



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
SENATI

VENDIM

Nr.13, datë 30.10.2018

"PËR

**MIRATIMIN E NENIT 16 TË STATUTIT TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS PËR  
KOMISIONET E PËRHERSHME PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 37, pika 1, neni 38, pika 1, gërma i dhe neni 46, pika 4, Vendimin Nr. 9, datë 02.02.2009 të Senatit Akademik "Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Senatit Akademik", si dhe me propozim të Rektoratit, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 30.10.2018,

VENDOSI:

1. Miratimin e nenit 16 të Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës për Komisionet e përhershme për dhënie e gradës shkencore "Doktor", sipas përcaktimeve të mëposhtme:
  - a. Komisioni për dhënie e gradës shkencore "Doktor" në Universitetin Politeknik të Tiranës, mban emërtimin "Këshilli i Profesorëve".
  - b. "Këshilli i Profesorëve" ngrihet mbi bazën e njësisë kryesore të UPT që ofron programe të ciklit të tretë.
  - c. Numri i anëtarëve të "Këshillit të Profesorëve" është 5 ose 7 anëtarë.
  - d. Anëtarët e "Këshillit të Profesorëve" në UPT, janë personel akademik me kohë të plotë të kategorisë "Profesor".
  - e. Anëtarët e "Këshillit të Profesorëve" në UPT vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga asambleja e njësisë kryesore, ku ata ushtrojnë funksionet e tyre. Ata kanë mandat dy vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
  - f. Funksionimi i "Këshillit të Profesorëve" në UPT përcaktohet në rregulloren e UPT dhe në rregulloren e njësisë kryesore, të cilat miratohen nga SAUPT.
2. Fillimin e procedurave për hartimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të komisioneve për dhënie e gradës shkencore "Doktor".

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
SENATI

---

3. Fillimin e procedurave të procesit zgjedhor për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore "Doktor".
4. Ngarkohen Drejtorja e Kërkimit Shkencor dhe Drejtorja Juridike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Rektori  
Prof. Dr. Andrea MALIQARI



---

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al